



Republika e Kosovës
Republika Kosova | Republic of Kosovo



Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Sudski Savet Kosova | Kosovo Judicial Council



Strategjia e Gjykatës Komerciale për vitet 2024 – 2025¹

¹ Mbështetur nga Programi i USAID për Drejtësi Komerciale

Tabela e përmbajtjes

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2
II. FJALA E KRYESUESIT TË KËSHILLIT GJYQËSOR TE KOSOVES.....	3
III. FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS KOMERCIALE	4
IV. ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E GJYKATËS KOMERCIALE.....	5-7
V. METODOLOGJIA	8-9
VI. MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT E GJYKATËS KOMERCIALE	10
VII. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	11-19
VIII. MONITORIMI DHE RAPORTIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË	20
IX. NDIKIMI FINANCIAR I STRATEGJISË.....	21
X. MENAXHIMI I RISKUT	22
XI. INDIKATORËT	23-27
XII. PLANI I VEPRIMIT.....	1-11

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia e Gjykatës Komerciale për vitet 2024 - 2025 është hartuar duke u mbështetur në vlerat, misionin, vizionin dhe qëllimet mbizotëruese të Strategjisë së Gjyqësorit për vitet 2023-2025.

Strategjia e Gjykatës Komerciale përmban katër objektiva strategjike mbi bazën e të cilave janë përcaktuar edhe qëllimet strategjike në funksion të avancimit të punës së Gjykatës. Kjo Strategji paraqet edhe nismën e parë të Gjykatës drejt planifikimit strategjik të saj dhe si e tillë synon që të ndikojë në rritjen e transparencës, qasjes dhe besueshmërisë së publikut në punën e Gjykatës si dhe në rritjen e efikasitetit të saj në zgjidhjen e lëndëve, rritjen e cilësisë së vendimeve, rritjen e profesionalizmit dhe bashkëpunimit me institucionet tjera.

Strategjia përmban pjesën hyrëse, përmbledhjen ekzekutive, metodologjinë e punës, analizën SWOT, objektivat strategjike dhe qëllimet strategjike në të cilat Gjykata synon të fokusohet në dy vitet e ardhshme. Progresi i arritjes së objektivave strategjike do të matet duke përdorur treguesit e identifikuar dhe caqet e synuara. Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të Strategjisë janë përfshirë në pjesën e VII-të të Strategjisë. Raportet për zbatimin e strategjisë pritet të bëhen në baza vjetore. Strategjia pritet t'i nënshtrohet shqyrtimit afatmesëm, jo më vonë se fundi i vitit 2024 për të vlerësuar efektivitetin dhe efikasitetin e zbatimit të saj ndërsa vlerësimi përfundimtar do të bëhet në fund të vitit 2025. Pjesa e VIII-të e Strategjisë paraqet ndikimin buxhetor që pritet të kenë aktivitetet e përcaktuara.

Plani i Veprimit është pjesë përbërëse e Strategjisë, i cili paraqet në mënyrë specifike të gjitha aktivitetet të cilat pritet të ndërmerren për të arritur objektivat e synuara, afatin kohor, përcakton njësitë dhe personat përgjegjës për secilin aktivitet, ndikimin buxhetor të tyre dhe produktet që do të dalin nga secili aktivitet.

II. FJALA E KRYESUSIT TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Në emër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke marr parasysh rolin dhe mandatin e këtij institucioni, e vlerësoj jashtëzakonisht shumë rëndësinë e kësaj Strategjie, jo vetëm për Gjykatën Komerciale, por për Sistemin Gjyqësor në përgjithësi.

KGJK, duke parë rëndësinë e kësaj Strategjie, ka ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me hartimin dhe implementimin e saj, si dhe do të vazhdoj të jap akoma kontributin e vet, në kuadër të autorizimeve kushtetuese dhe ligjore, lidhur me zbatimin e plotë të kësaj strategjie.

Strategjia e Gjykatës Komerciale për vitet 2024 - 2025, paraqet një dokument me rëndësi jetike në vazhden e akteve të miratuara nga Këshilli, me ç'rast KGJK vazhdon t'i përmbush detyrat dhe përgjegjësitë e veta, me qëllim të administrimit të gjyqësorit.

Po ashtu, strategjia, në përmbajtjen e saj, garanton mbrojtjen dhe realizimin e drejtave të palëve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, ngase i mundëson gjykatës funksionimin efikas dhe efektiv, duke fuqizuar nivelin e shërbimeve të ofruara për qytetarët, zgjidhjen e lëndëve në afat të arsyeshëm, si dhe duke rritur besimin e publikut në Sistemin Gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, jam falënderues ndaj të gjithë atyre që ofruan mbështetjen profesionale në hartimin e kësaj strategjie, të cilët me punën dhe ekspertizën e tyre, kontribuojnë që të kemi një gjyqësor akoma më të mirëfilltë.

Në fund, dua t'i inkurajoj gjithë personelin e kësaj gjykatë, që ta shfrytëzojnë tërë kapacitetin personal dhe profesional, me qëllim që strategjia të jetësohet në praktikë, duke i garantuar edhe mbështetjen e pakursyer dhe të nevojshme nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Albert Zogaj
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

III. FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS KOMERCIALE

*Në emër të Gjykatës Komerciale kam kënaqësinë që të prezantoj **Strategjinë e Gjykatës Komerciale për vitet 2024 – 2025** e cila është në harmoni me **Strategjinë për Gjyqësorin për vitet 2023-2025**.*

Është një moment i rëndësishëm për ne, pasi Strategjia është thelbi i misionit dhe qëllimit tonë si një institucion i drejtësisë. Strategjia jonë është udhërrëfyese që na drejton drejt arritjes së qëllimeve tona dhe sigurimit të një sistemi gjyqësor të fuqishëm dhe efektiv.

Gjatë dy viteve të ardhshme, Gjykata Komerciale do t'i përqendrojë përpjekjet në katër objektiva strategjike parësore të cilat përputhen me Misionin, Vizionin dhe Vlerat e Gjykatës sonë.

Strategjia jonë përfshinë katër objektiva strategjike që kanë për qëllim përmirësimin e shërbimeve tona, promovimin e efikasitetit, rritjen e ekspertizës në fushë komerciale, komunikimin me publikun dhe promovimin e një mjedisi të qëndrueshëm për bizneset në Kosovë.

Ne po punojmë për të siguruar që të gjitha palët dhe personat që përfshihen në sistemin tonë të kenë besim në procesin gjyqësor dhe të ndihen të trajtuar me respekt dhe drejtësi.

Për mua, një pjesë e rëndësishme e Strategjisë sonë është dhe mbështetja e stafit tonë, duke siguruar se ata kanë resurset dhe trajnimin e nevojshëm për të bërë punën e tyre me përkushtim dhe kompetencë.

Në fund, dua të theksoj se ky nuk është vetëm një dokument zyrtar, por një hap rrënjësor që do të na ndihmojë të kalojmë nga fjalët në vepra.

Do të doja të falënderoja Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Programin e USAID-it për Drejtësi Komerciale për mbështetjen në hartimin e kësaj Strategjie që kanë ndihmuar në shumë mënyra për të arritur deri këtu. Mbështetja, ekspertiza dhe përkushtimi i tyre janë burime të çmuara për ne.

Përtej partnerëve tanë, dua të falënderoj të gjithë stafin e Gjykatës Komerciale dhe të gjithë ata që janë përfshirë në këtë rrugë të rëndësishme drejt përmirësimit. Jemi një ekip i përkushtuar që ka për qëllim të sjellë ndryshime pozitive në shoqërinë tonë dhe të sigurojë një të ardhme më të ndritur për të gjithë.

Ju ftoj të bashkoheni me mua dhe stafin tonë në këtë udhëtim dhe të ndihmoni në zbatimin e kësaj Strategjie në mënyrë që të bëhemi një Gjykatë më e fuqishme dhe më e efektshme për të gjithë qytetarët tanë.

Mahir Tutuli

Kryetar i Gjykatës Komerciale të Republikës së Kosovës

IV. ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E GJYKATËS KOMERCIALE

Me 21 janar 2022 Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Gjykatën Komerciale i cili krijoi bazën ligjore për themelimin e Gjykatës Komerciale.

Gjykata Komerciale është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës e cila operon brenda kornizës ekzistuese të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe parimeve të saj. Gjykata Komerciale ka filluar punën me 1 gusht 2022, ka juridiksion të gjerë dhe shtrihet në të gjitha kërkesat që vijnë nga bizneset. Gjykata Komerciale përbëhet nga dy instanca: Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale janë kompetente për të trajtuar:

- të gjitha ankesat ndaj vendimeve të dhomave të shkallës së parë;
- të gjitha ankesat ndaj një urdhri për transferimin, apo refuzimin për transferim, të një rasti brenda departamenteve të shkallës së parë, që janë parashtruar brenda afatit të caktuar;
- konfliktet e juridiksionit nga dhomat e shkallës së parë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve;
- çështjet tjera siç mund të parashikohen me ligj.

Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale kanë katër (4) Departamente të veçanta, përfshirë Departamentin për Çështje Ekonomike, Departamentin Fiskal, Departamentin për Çështje Administrative dhe Departamentin e Përgjithshëm. Në kuadër të Departamentit për Çështje Ekonomike operon Divizioni për Investitorë të Huaj, me juridiksion për tërë territorin e Kosovës. Gjyqtarët e caktuar në këtë Divizion sipas nevojës do të angazhohen edhe në Departamentet tjera të Gjykatës.

Dhomat e Shkallës së Parë janë kompetente për të trajtuar:

- kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre;
- të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbartimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate;
- njohjen dhe lejimin e zbatimit të vendimeve të arbitrazhit vendor dhe ndërkombëtar;
- kontestet gjyqësore që rrjedhin nga Ligji në fuqi për Shoqëritë Tregtare;
- riorganizimi, falimentimi dhe shuarja e shoqërive tregtare;
- kontestet në lidhje me pengimin e posedimit në mes të shoqërive tregtare;
- kontestet në mes shoqërive tregtare lidhur me të drejtat sendore, siç është e paraparë me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare;
- kontestet që lidhen me shkeljen e konkurrencës, keqpërdorimit ose monopolit dhe pozitës dominuese në treg, si dhe marrëveshjet monopole duke përfshirë vlerësimin e paligjshmërisë;
- mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe pronësisë industriale, përfshirë markat tregtare, patentat, dizajnet industriale, sekretet tregtare dhe format e tjera të pronësisë industriale, siç parashihet nga legjislacioni përkatës;
- kontestet ndërmjet kompanive të aviacionit që i nënshtrohen Ligjit për Aviacionin, duke përjashtuar kontestet në lidhje me të drejtat e pasagjerëve;
- kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare të Administratës Tatimore, Autoriteteve Doganore, Ministrisë së

Financave dhe çdo organi tjetër publik përgjegjës për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve të tjera shtetërore;

- kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative;
- çështje të tjera siç mund të parashikohen me ligj.

Njësia Ligjore - është njësi organizative në Gjykatën Komerciale e cila performon detyrat në mbështetjen profesionale të gjyqtarëve, duke bërë hulumtime ligjore dhe analiza, asistim në hartimin e raporteve, vendimeve dhe çështjeve tjera ligjore në mbështetje të punës së gjyqtarëve të Gjykatës Komerciale. Njësia Ligjore hulumton legjislacionin, autoritetet ligjore dhe jurisprudencën lidhur me lëndët që janë duke u zgjidhur nga Gjykata, nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të gjyqtarit përgjegjës për lëndën e Dhomës së Shkallës së Parë apo të gjyqtarit raportues të Panelit Shqyrtues të Dhomave të Shkallës së Dytë. Më gjerësisht, personeli i Njesisë Ligjore vepron në mbështetje të Gjykatës dhe nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Gjykatës.

Njësia Ligjore përbëhet nga:

- Këshilltari Ligjor që vepron edhe si Kreu i Njesisë Ligjore;
- Bashkëpunëtorët profesional;
- Sekretarët juridikë;
- Personel tjetër administrativ apo përkrahës sipas kërkesës.

Administratori i Gjykatës Komerciale - menaxhon dhe mbikëqyrë funksionet administrative të Gjykatës në mënyrë autonome, në bashkëpunim me Kryetarin e Gjykatës dhe në koordinim me Sekretariatit e KGJK-së. Administratori i Gjykatës mbikëqyrë:

- hartimin e raporteve të Gjykatës, duke përfshirë raportet statistikore dhe të sigurojë që të njëjtat të jenë të sakta dhe të përgatiten me kohë;
- regjistrimin dhe arkivimin e dosjeve të Gjykatës dhe lëndëve të mbyllura;
- mirëmbajtjen e dosjeve të Gjykatës në formë të plotë dhe të saktë;
- sigurinë e Gjykatës;
- stafin administrativ të Gjykatës;
- zbatimin e rregulloreve për personelin gjyqësor;
- mirëmbajtjen e saktë të financave;
- zbatimin e rregulloreve të KGJK-së dhe procedurat e themeluara nga KGJK.

Zyra për Informim dhe Komunikim me Media - është përgjegjëse për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me informimin e mediave dhe publikut për punët dhe aktivitetet e Gjykatës. Udhëheqësi i kësaj zyre është përgjegjës për të mbledhur dhe shpërndarë të gjitha dokumentet dhe të dhënat e Gjykatës në të cilat mund të ketë qasje publiku për qëllime informative apo edukative. Varësisht nga natyra e pyetjes ose kërkesës, të njëjtat i drejton tek personat përgjegjës, përkatësisht te Kryetari i Gjykatës, gjyqtari i çështjes ose Administratorit të Gjykatës.

Zyra për Menaxhimin e Lëndëve (ZML) - mundëson procedimin e lëndëve në mënyrë transparente dhe me kohë. ZML është përgjegjëse për lëvizjen e lëndëve brenda gjykatës nga regjistrimi e deri tek përfundimi. Udhëheqësi i ZML raporton për punën e tij tek Administratori i Gjykatës.

Zyra për Shërbime të Përbashkëta - është përgjegjëse për sigurimin e objektit dhe personelit të Gjykatës, mirëmbajtjen e objektit dhe pajisjeve. Kjo Zyrë është përgjegjëse edhe për furnizimin me pajisje të sigurimit, automjete, kompjuterë, material shpenzues, etj.

Zyra për Buxhet dhe Financa - është përgjegjëse për përgatitjen e planifikimit, menaxhimin, ekzekutimin e shpenzimeve të Gjykatës, propozimit të buxhetit të Gjykatës, përpilimin e kërkesave të nevojshme, siç përcaktohet me legjislacionit në fuqi dhe aktet e miratuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

V. METODOLOGJIA

Hartimit të Strategjisë i ka paraprirë një proces i detajuar i mbledhjes së të dhënave për situatën aktuale dhe përcaktimin e objektivave strategjike. Procesi i zhvillimit të Strategjisë ka kaluar nëpër hapat si në vijim:

Zhvillimi i pyetësorit me gjyqtarët dhe stafin mbështetës të Gjykatës Komerciale, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, avokatët e licencuar në Odën Avokatëve të Kosovës, Odën Ekonomike të Kosovës – Hapi i parë i ndërmarrë në hartimin e Strategjisë ka qenë mbledhja e të dhënave dhe perceptimeve përmes pyetësorit online për të marrë kontributin dhe mendimin e tyre për punën, problemet dhe të arriturat e Gjykatës Komerciale. Me mbështetjen e Programit të USAID-it për Drejtësi Komerciale, pyetësori është zhvilluar me gjyqtarët dhe personelin e Gjykatës Komerciale, me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me avokatët e licencuar në Odën e Avokatëve të Kosovës, dhe me Odën Ekonomike të Kosovës.

Punëtorja për analizën SËOT² – është mbajtur me 11 dhe 12 maj 2023 me gjyqtarët dhe personelin e Gjykatës Komerciale, për të identifikuar përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet e mundshme për punën e Gjykatës Komerciale. Përmes analizës SËOT është bërë vlerësimi i faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm si dhe potenciali i tanishëm dhe i ardhshëm. Gjatë punëtorisë, pjesëmarrësit punuan në grupe për të nxjerrë analiza reale të situatës.

Punëtorja për objektivat strategjike të Gjykatës Komerciale – është mbajtur me 20 qershor 2023 me gjyqtarët dhe personelin e Gjykatës Komerciale. Të dhënat e dala nga analiza SËOT kanë shërbyer për të përcaktuar objektivat strategjike, vlerat, deklaratat e misionit dhe vizionit të Gjykatës Komerciale si dhe kanë shërbyer si bazë e mirë për zhvillimin e Strategjisë tutje.

Hartimi – Pas hapave të ndërmarrë si më lartë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës themeloi Grupin Punues për hartimin e Strategjisë së Gjykatës Komerciale për vitet 2024-2025, anëtarët e të cilit kanë punuar në hartimin e përmbajtjes së Strategjisë së Gjykatës Komerciale. Përveç takimeve të shumta të punës së gjyqtarëve dhe menaxhmentit të Gjykatës Komerciale, Grupi Punues ka mbajtur edhe dy punëtori:

- **Punëtorja e parë për hartimin e Strategjisë së Gjykatës Komerciale** – është mbajtur me 16 dhe 17 tetor 2023, në të cilën anëtarët e grupit punues finalizuan deklaratat e misionit, vizionit, vlerave të Gjykatës Komerciale, hartuan objektivave strategjike të saj, qëllimet strategjike, Planin Buxhetor, Planin për Monitorim dhe Raportim të saj si dhe Planin e Veprimit të Strategjisë.
- **Punëtorja e dytë për hartimin e Strategjisë së Gjykatës Komerciale** – është mbajtur me 14 dhjetor 2023, në të cilën Kryesuesi i Grupit Punues bëri prezantimin e draftit dhe anëtarët e Grupit Punues e finalizuan hartimin e draftit të Strategjisë.

² SWOT paraqet akronim anglez: **Strengths, Weaknesses, Opportunities and Threats** që nënkupton Analizën e përparësive, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve të një organizate

ANALIZA SWOT

PËRPARËSITË

Lidershipi
Ekspertiza dhe specializimi
Staf profesional dhe i përkushtuar
Gjyqtarë dhe staf të rinj dhe të motivuar
Përkrahje nga menaxhmenti
Energji e re, fillim i ri, energji pozitive
Përkrahje ndërkombëtare, veçanërisht nga USAID
Ofrim i sigurisë juridike për bizneset
Adresë e vetme për bizneset
Zgjidhja e shpejtë e rasteve të përmbarimit
Gjykatë e re e specializuar, e funksionalizuar
Trendi i rritjes së besimit në Gjykatë
Kapaciteti në ngritje për zgjidhjen e rasteve komplekse

DOBËSITË

Buxheti dhe resurse të pamjaftueshme njerëzore
Mungesë e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të Gjykatës
Mungesa e sallave të gjykatës
Mundësi e limituar për trajnime dhe specializime të avancuara për t'iu përshtatur zhvillimeve dinamike në fushën komerciale
Mosfunksionalizimi i plotë I përdorimit të teknologjisë
Kufizime të autorizimeve të menaxhmentit
Vendimmarrja për çështjet kryesore të Gjykatës nga organet jashtë Gjykatës
Mbingarkesa melëndë, rastet e vjetra
Mungesa e automatizimit efektiv në menaxhimin e lëndëve
Rezistenca ndaj ndryshimit
Mungesa e guximit për të krijuar praktika të reja
Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve
Mungesa e praktikës së konsoliduar
Informacion i pamjaftueshëm për biznesin
Mungesa e ndërgjegjësimit të publikut

MUNDËSITË

Përmirësimi i cilësisë së shërbimit
Krijimi i sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë së vendimeve gjyqësore
Rritja e efikasitetit dhe shkurtimi i afatit kohor në zgjidhjen e rasteve
Ngritja e kapaciteteve profesionale të specializuara të gjyqtarëve dhe personelit tjetër të Gjykatës
Digjitalizimi i proceseve dhe procedurave
Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave me vende të tjera
Gjykatë model në ofrimin e shërbimeve në Kosovë
Evidentimi dhe përcaktimi i qartë i procedurave të brendshme
Zbatimi i Planeve të Veprimit dhe reduktimi i rasteve
Funksionalizimi i SMIL
Organizimi i trajnimeve për stafin Organizimi i trajnimeve të brendshme dhe mentorimi për personelin
Monitorimi nga media dhe publiku i punës së gjykatës
Komunikimi elektronik me palët
Rritja e klimës së biznesit duke ofruar mekanizma transparentë dhe të besueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tregtare
Kontribuimi në zhvillimin e përgjithshëm të sektorit tregtar
Përmirësimi i shtrirjes dhe angazhimi në fushata ndërgjegjësuese për të promovuar punën e Gjykatës Komerciale

RREZIQET

Proces i imponuar i vetingut
Procedurat e ndryshimit të legjislacionit komercial dhe bartja e kompetencave gjyqësore në organet jashtëgjyqësore administrative
Mungesa e bashkëpunimit efektiv me KGJK-në
Pamjaftueshmëri e financave për funksionalizim të plotë
Gjyqësor i mbingarkuar me raste
Mungesa e stafit
Automatizimi i pamjaftueshëm
Mungesa e standardeve dhe manualeve të procedurave të brendshme
Vëmendje e shtuar nga të tjerët në punën e gjykatës
Pengesat e komunikimit me palët në procedurë
Komunikimi jo i duhur i stafit

VI. MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT E GJYKATËS KOMERCIALE

5.1. MISIONI

Gjykata Komeriale ka mision zgjidhjen e kontesteve komerciale efektivisht dhe brenda kohës së arsyeshme, rritjen e sigurisë juridike për bizneset dhe mbështetjen e një mjedisi të qëndrueshëm dhe të favorshëm për bizneset dhe investimet e huaja në Kosovë.

5.2. VIZIONI

Gjykata Komeriale ka vizion të jetë një institucion i njohur dhe i besueshëm në drejtësinë komerciale, që kontribuon në rritjen dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë përmes zgjidhjes së kontesteve tregtare, duke mbajtur standardet më të larta të sjelljes gjyqësore dhe profesionale si dhe duke siguruar sundimin e ligjit dhe qasjen në drejtësi.

5.3. VLERAT

Vlerat tona janë parimet themelore që na udhëheqin në punën tonë dhe janë thelbësore për të siguruar drejtësinë:

SUNDIMI I LIGJIT Ne mbështesim sundimin e ligjit dhe sigurojmë që të gjitha veprimet tona janë në përputhje me parimet e vendosura.	INTEGRITETI NË PUNËN TONË Veprimet tona janë në përputhje me standardet më të larta profesionale dhe etike.	PAANSHMËRIA Ne garantojmë paanshmërinë dhe sigurojmë që të gjitha palët e përfshira trajtohen në mënyrë të drejtë dhe barabartë.	PROFESIONALIZMI Gjyqtarët kanë njohuri dhe janë të specializuar në të drejtën komerciale për të trajtuar në mënyrë efektive çështjet komplekse komerciale.
EFIKASITETI Zgjidhja në kohë e kontesteve është thelbësore për bizneset dhe ne synojmë të zvogëlojmë kohëzgjatjen e procedurës duke ruajtur drejtësinë dhe procesin e rregullt.	TRANSPARENCA Ne i bëjmë të qasshme proceset dhe punën tonë për publikun si dhe ofrojmë arsyetime të qarta për vendimet tona.	ANGAZHIMI I KOMUNITETIT Ne angazhohemi me komunitetin e biznesit dhe palët e interesuara për të kuptuar nevojat dhe shqetësimet e tyre, duke nxitur një ndjenjë besimi dhe bashkëpunimi.	QASJA NË DREJTËSI Ne jemi të qasshëm për bizneset që kërkojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve komerciale dhe çështjeve tjera brenda autorizimeve tona. Kjo përfshin ofrimin e informacioneve, ndihmës dhe qasjes në drejtësi.

VII. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Objektivat strategjike të Gjykatës Komerciale përshkruajnë synimet dhe planet dyvjeçare të saj. Strategjia përmban katër objektiva strategjike kryesore:

- Objektiva strategjike 1: Drejtësi e parashikueshme dhe brenda kohës së arsyeshme
- Objektiva strategjike 2: Rritja e ekspertizës në fushën komerciale
- Objektiva strategjike 3: Komunikimi me publikun dhe mediet, vendosja dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet tjera
- Objektiva strategjike 4: Promovimi i një mjedisi të qëndrueshëm për bizneset në Kosovë

7.1. OBJEKTIVA STRATEGJIKE 1: DREJTËSI E PARASHIKUESHME DHE BRENDA KOHËS SË ARSYESHME

Drejtësia e parashikueshme nxit krijimin e ambientit stabil për bizneset, duke tërhequr investimet e huaja dhe inkurajimin e rritjes ekonomike. Drejtësia e parashikueshme në Gjykatën Komerciale i referohet drejtësisë komerciale ku vendimet janë konsistente, transparente dhe të besueshme.

Drejtësia në kohë i referohet zgjidhjes së shpejtë dhe të efektshme të kontesteve duke siguruar që të drejtat e palëve mbrohen dhe drejtësia ofrohet pa vonesa. Drejtësia brenda kohës së arsyeshme paraqet aspekt vendimtar të çdo sistemi të drejtësisë së efektshme dhe të drejtë.

Gjykata Komerciale synon të arrijë drejtësinë e parashikueshme, të përmirësojë cilësinë e vendimeve dhe të zvogëlojë kohën e zgjidhjes së lëndëve duke zbatuar procedura të thjeshta, duke përdorur teknologjinë për menaxhimin e rasteve, duke i referuar lëndët e përshtatshme në ndërmjetësim si mekanizëm për zgjidhjen alternative të kontesteve dhe praktikatat më të mira në zgjidhjen e kontesteve komerciale.

Qëllimi strategjik 1.1: Ngritja e cilësisë së vendimeve

Vendimet e cilësisë së lartë janë thelbësore për funksionimin e një sistemi të drejtë dhe efikas dhe në rritjen e besimit të publikut në sundimin e ligjit.

Ngritja e cilësisë së vendimeve është qëllim primar për Gjykatën Komerciale e cila përfshin krijimin e një praktike unike të vendimmarrjes e cila do të krijojë siguri juridike dhe vendimet do të jenë të parashikueshme për palët.

Domosdoshmërinë për vendime cilësore e bën fakti që në kontestet që zgjidh Gjykata Komerciale shpeshherë përfshihen elemente të huaja përkatësisht si palë paraqiten kompani nga vende me jurisprudencë të zhvilluar në fushën komerciale, andaj cilësia e vendimeve të Gjykatës duhet të përmbush standardet që mbajnë gjykatat e vendeve tjera pasi kjo shpërfaq edhe nivelin e gjyqësorit të Kosovës. Prandaj vendimet e Gjykatës Komerciale duhet t'i referohen jo vetëm instrumenteve ligjore vendore por edhe atyre ndërkombëtare në rastet kur janë të aplikueshme.

Për të arritur këtë, faktor kyç në përmirësimin e cilësisë së vendimeve paraqet edhe përdorimi dhe qasja në platforma online të institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare si dhe zhvillimi i kapaciteteve të Gjykatës për kërkime dhe hulumtime ligjore.

Qëllimi strategjik 1.2: Përmirësimi i infrastrukturës dhe burimeve të Gjykatës

Gjykata Komerciale aktualisht vepron në mjedise që nuk përmbushin kërkesat hapësinore për punë. Duke vlerësuar këtë, Gjykata Komerciale duhet të ketë hapësira të mjaftueshme dhe të rregullta për palët si dhe për të gjithë stafin e Gjykatës, prandaj është e nevojshme zhvendosja në objekt tjetër, ku do të ketë më shumë hapësirë pune dhe kushte optimale për punë. Pas zhvendosjes në objektin e ri, kërkohet garantimi i kushteve të sigurisë dhe të shëndetit brenda hapësirave të punës. Për më tepër, është e rëndësishme të trajtohen në kohën e duhur dhe në përputhje me aktet ligjore të zbatueshme, nevojat e personelit dhe vetë Gjykatës, duke përfshirë identifikimin në kohë të nevojave për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, bazuar në planin buxhetor të përgatitur nga Gjykata. Ofrimi i shërbimeve mbështetëse adekuate dhe në kohën e duhur ka gjithashtu një efekt të drejtpërdrejtë në realizimin e qëllimeve strategjike të Gjykatës.

Megjithëse Gjykata Komerciale ka filluar punën në gusht të vitit 2022, ajo ende po ballafaqohet me sfida në ngritjen e kapaciteteve institucionale, mungesën e resurseve njerëzore dhe teknike për të kryer në mënyrë të rregullt autorizimet e saj. Përveç moskompletimit të numrit të gjyqtarëve të angazhuar edhe nga komunitetet joshumicë, gjykata funksionon edhe me kapacitete jo të plota të stafit tjetër mbështetës dhe pozitave administrative të cilat përcaktohen me organogramin e Gjykatës Komerciale. Andaj është e domosdoshme të zhvillohet procedura e rekrutimit për plotësimin e pozitave të lira, ku duhet të synohet gjithashtu përfaqësim i barabartë gjinor.

Me plotësimin e të gjitha pozitave të cilat përcaktohen me organogramin e Gjykatës Komerciale, pritet që Gjykata të jetë plotësisht funksionale dhe trajtimi i lëndëve të bëhet në përputhje me afatet ligjore, e cila rezulton në krijimin e sigurisë juridike dhe rritjen e besimit të publikut në punën e Gjykatës Komerciale.

Qëllimi strategjik 1.3: Unifikimi i praktikës gjyqësore

Me ristrukturimin e gjykatave në Kosovë në vitin 2013, dhe me funksionalizimin e Departamentit për Çështje Ekonomike³ që ka vepruar në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës ka filluar të krijohet praktikë gjyqësore edhe nga fusha komerciale. Megjithëse kjo praktikë gjyqësore nuk është konsoliduar në ndonjë dokument, e njëjta shërben si bazë për të ruajtur konsistencën e vendimeve edhe nga gjyqtarët e Gjykatës Komerciale.

Gjykata Komerciale me qëllim të unifikimit të praktikës gjyqësore nga fusha komerciale synon të përmbledh praktikën gjyqësore në një Buletin Gjyqësor nga fusha komerciale. Kjo synohet të arrihet përmes bashkëpunimit intensiv të gjyqtarëve në unifikimin e praktikës gjyqësore në pajtim me standardet vendore dhe ndërkombëtare si dhe përmes arsytimeve cilësore dhe gjithëpërfshirëse të vendimeve gjyqësore.

Qëllimi strategjik 1.4: Zvogëlimi i stoqeve të lëndëve të vjetra

Ndër synimet kryesore të reformës në drejtësinë komerciale do të jetë edhe zvogëlimi i kohëzgjatjes së kontesteve komerciale. Gjykata Komerciale ka filluar punën me afërsisht 10,000 lëndë të transferuara nga gjykatat tjera si rezultat i kompetencave të zgjeruara me Ligjin për Gjykatën Komerciale për dallim nga kompetencat që i ka pasur Departamenti

³ Divizion Fiskal i Departamentit për Çështje Administrative

për Çështje Ekonomike⁴, ndërsa brenda vitit 2023 ka pranuar afërsisht 4,742 lëndë të reja në shkallën e parë dhe 1,730 lëndë të reja në shkallën e dytë, pra gjithsej 6,472 për të dy shkallët⁵.

Gjykata Komerciale në ditën e parë të fillimit të punës është ballafaquar me numër enorm të lëndëve të transferuara nga gjykatat tjera dhe si të tilla për shkak të vjetërsisë dhe natyrës së tyre janë lëndë të ndërlikuara për tu zgjidhur. Për këtë arsye, është e nevojshme që të ndërmerren disa masa dhe veprime specifike për zvogëlimin e stoqeve të cilat do të ndikojnë në zgjidhjen e lëndëve në kohë. Me qëllim të reduktimit të stoqeve të lëndëve, vitin e kaluar Gjykata Komerciale ka hartuar **Planin e veprimit për Reduktimin e Lëndëve, Maj – Dhjetor 2023**. Duke marrë parasysh natyrën dhe kompleksitetin e çështjeve, paraqitet i domosdoshëm plotësim/ndryshimi i **Planit strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025 efikasiteti dhe priorizimi i lëndëve brenda sistemit gjyqësor**, me qëllim që të adresohen nevojat specifike në trajtimin e lëndëve të Gjykatës Komerciale.

Në këtë drejtim do të ishte e domosdoshme që të gjitha lëndët e pranuar deri në vitin 2021 të trajtohen si lëndë të vjetra të së njëjtës kategori, ashtu që gjyqtarët që janë të ngarkuar me këto lëndë të mund t'i trajtojnë sipas vlerësimit të tyre, përkundër faktit që kjo mënyrë do të bënte përjashtim nga **Plani strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025 efikasiteti dhe priorizimi i lëndëve brenda sistemit gjyqësor**. Ky përjashtim do të mundësonte ngritjen e efikasitetit të Gjykatës sepse një numër relativisht i vogël i lëndëve të vjetra të cilat për shkak të kompleksitetit nuk mund të përfundohen andaj dhe ua pamundësojnë gjyqtarëve trajtimin e lëndëve tjera të vjetra për shkak të kriterëve të përcaktuara në Planin Strategjik të KGJK-së dhe kjo ndikon dukshëm në zvogëlimin e efikasitetit të Gjykatës.

Qëllimi strategjik 1.5: Funkcionalizimi i sistemit digjital për menaxhimin e lëndëve

Gjykata Komerciale ka filluar përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (TIK/SMIL). Ky sistem është në funksionalizim e sipër, megjithatë menaxhimi i lëndëve bëhet ende edhe fizikisht.

Gjykata synon digjitalizimin, si mjet potencial për të përmirësuar menaxhimin e punës së përditshme dhe shpejtësinë e rrjedhës së informacionit dhe proceseve. Gjykata synon avancimin në menaxhimin e lëndëve, ku përveç pjesës së kualitetit të shënimeve, do të konsiderohet përditësimi i Sistemit gjatë regjistrimit të shënimeve në sistem. Kjo afekton të gjithë rrjedhën e procesit, nga reduktimi dhe mospërsëritja e informacionit të njëjtë si mjet kyç i optimizimit të procesi të përgjithshëm dhe thjeshtësimit të përdorimit të sistemit, e gjithë kjo pas integritimit të sistemit ekzistues SMIL.

Konsiderohet se janë të domosdoshme sistemet për analizë dhe raportim, respektivisht *'dataëarehouse'*⁶ si mjete adekuate të teknologjisë informative. Sisteme të tilla janë thelbësore për të mbështetur menaxhimin e Gjykatës në mënyrë efektive.

⁴ i cili ka vepruar në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës

⁵ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/1682_KGJK_Raporti_Statistikor_Gjykatave_Vietori_2023.pdf

⁶ "Datawarehouse" nënkupton një sistem të organizuar dhe optimizuar për të mbajtur, ruajtur dhe menaxhuar të dhënat nga burime të ndryshme.

Identifikimi i secilit prej hapave apo aktiviteteve në lëndë, nga pranimi deri në vendimin përfundimtar ofron mundësi për monitorim dhe vlerësim të aktiviteteve të Gjykatës, me qëllim të përmirësimit të performancës së saj. Për më tepër, digjitalizimi paraqet një instrument të rëndësishëm që do t'i shërbejë Njësisë Ligjore dhe gjyqtarëve në menaxhimin adekuat dhe në kohë të lëndëve si dhe në identifikimin dhe përdorimin më të lehtë të praktikës së mëhershme gjyqësore. Gjykata Komerciale aktualisht nuk ka ndonjë manual për format standarde të operimit dhe menaxhimit të lëndëve. Konsiderohet se është e domosdoshme zhvillimi i manualit për menaxhimin e lëndëve, i cili ndër të tjera do të përcaktojë kornizën dhe praktikën standarde të menaxhimit të lëndëve, për të siguruar që lëndët do të trajtohen në mënyrë konsistente, të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme duke respektuar pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të palëve.

Për realizimin e këtij qëllimi strategjik, është e domosdoshme mbështetja shtesë nga ana e KGJK-së.

Qëllimi strategjik 1.6: Përdorimi i ndërmjetësimit si mekanizëm për zgjidhjen alternative të kontesteve

Inkurajimi i përdorimit të mekanizmave për zgjidhjen alternative të kontesteve siç është ndërmjetësimi, mund t'i ndihmojë palët të zgjidhin kontestet më shpejtë dhe të shmangin procedimet e gjata gjyqësore.

Ndërmjetësimi do të kontribuojë në zbatimin e të drejtës për një gjykim brenda një kohe të arsyeshme dhe brenda parimeve të arritshmërisë së gjyqësorit dhe t'u mundësojë bizneseve të zgjidhin kontestet jashtë sistemit gjyqësor. Në këtë mënyrë, ngarkesa e punës së gjykatës do të pakësohet përmes zgjidhjes më të shpejtë dhe me kosto-efektive të kontesteve, e cila gjithashtu mundëson që palët të mbajnë bashkëpunimin mes tyre.

7.2. OBJEKTIVA STRATEGJIKE 2: RITJA EKSPERTIZËS NË FUSHËN KOMERCIALE

Gjykata Komeriale synon rritjen e specializimit dhe ekspertizës në fushën komerciale. Kjo përfshin trajnime të vazhdueshme dhe mundësi për zhvillim profesional për gjyqtarët dhe personelin tjetër të Gjykatës.

Gjykata do të ketë prioritet që gjyqtarët dhe i gjithë personeli të kenë trajnimet adekuate në mënyrë që t'i kryejnë funksionet e tyre efektivisht. Rritja e njohurive profesionale, shkathtësive analitike dhe kërkimore të stafit profesional, shkathtësive dhe njohurive të personelit administrativ në mënyrë që të jenë më efektiv, efikas, etik dhe profesional në punën e tyre do të jetë prioritet i Gjykatës. Përveç trajnimeve që organizon Akademia e Drejtësisë, për të rritur kapacitetin profesional të gjyqtarëve dhe stafit profesional do të organizohen trajnime brenda vet Gjykatës, ku si trajner do të angazhohen gjyqtarët me përvojë. Brenda tre mujorit të parë të vitit 2024, Gjykata do të bëjë analizimin dhe vlerësimin e nevojave për trajnime dhe do të dalë me planin konkret për temat e trajnimeve, oraret dhe gjyqtarët të cilët do të angazhohen për të mbajtur këto trajnime.

Qëllimi strategjik 2.1: Trajnimet për gjyqtarët

Akademia e Drejtësisë ofron Programin e Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar dhe Programin e Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV) i cili ka për qëllim ofrimin e trajnimeve për gjyqtarët.

Rritja e ekspertizës së gjyqtarëve në fushën komerciale është esenciale për të siguruar që Gjykata Komeriale efektivisht do t'i zgjidh kontestet komplekse komerciale. Duke marrë parasysh natyrën e kontesteve komerciale dhe kompleksitetin e tyre, është e domosdoshme që në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë të përfshihen module të reja në Programin e Trajnimeve të Vazhdueshme me qëllim të përmbushjes së nevojave për trajnime specifike për gjyqtarët.

Përveç kësaj, është e domosdoshme të zhvillohen programe mentoruese ku gjyqtarët me eksperiencë të gjykatave komerciale të vendeve tjera apo dhe ekspertë të fushave me interes për gjyqtarët do të mund të mentorojnë gjyqtarët e Gjykatës Komerciale. Kjo do të mund të arrihet përmes mbështetjes së Këshillit Gjyqësor në themelimin e bashkëpunimit me gjykatat komerciale të rajonit dhe më gjerë. Gjithashtu është e domosdoshme që të rritet qasja e gjyqtarëve në burime të ndryshme ligjore, përfshirë databazat dhe librari elektronike për t'i përkrahur në procesin e vendimmarrjes.

Qëllimi strategjik 2.2: Trajnimet për Njësinë Ligjore

Njësia Ligjore paraqet shtyllën kryesore mbështetëse të Gjykatës Komerciale dhe profesionalizmi i saj është shumë i rëndësishëm në nxjerrjen e vendimeve gjyqësore cilësore.

Njësia Ligjore ka staf profesional dhe të motivuar, megjithatë duke marrë parasysh kompleksitetin e lëndëve komerciale, ndryshimet ligjore dhe zhvillimet në fushën komerciale, Gjykata Komeriale synon që të përmirësojë kapacitetet e Njesisë Ligjore përmes trajnimeve nga fusha komerciale dhe fusha të tjera.

Funksioni primar i Njesisë Ligjore është përgatitja dhe mbështetja profesionale e gjyqtarëve në draftimin e vendimeve gjyqësore. Për këtë kërkohet që në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë të ofrohen trajnimet adekuate me qëllim të përmbushjes së nevojave për ngritje të njohurive të tyre për tema specifike si dhe për të rritur aftësitë e tyre në hartimin dhe arsyetimin ligjor të vendimeve si dhe aftësitë kërkimore dhe hulumtuese në mënyrë që të mund të mbështesin gjyqtarët edhe në zgjidhjen e lëndëve komplekse komerciale.

Përveç kësaj, sikurse edhe për gjyqtarët edhe për Njësine Ligjore është e domosdoshme që të zhvillohen programe mentoruese, ku gjyqtarë me eksperiencë dhe profesionistë tjerë ligjorë të gjykatave komerciale të vendeve tjera apo dhe ekspertë të fushave përkatëse, do të mentorojnë Njësine Ligjore. Gjithashtu është e domosdoshme që të rritet qasja e stafit të Njesisë Ligjore në burime të ndryshme ligjore, përfshirë databazat dhe librari elektronike për t'i përkrahur në punën e tyre.

Qëllimi strategjik 2.3: Trajnimet për Administratën

Akademia e Drejtësisë zhvillon programe trajnimi me qëllim të ngritjes së shkathtësive profesionale edhe të profesionistëve tjerë të gjykatave të cilët janë pjesë dhe kontribuojnë drejtpërdrejtë në sistemin gjyqësor të Kosovës.

Në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë, është e domosdoshme që të ofrohen trajnimet adekuate për Administratën e Gjykatës për t'i mbështetur në punën e tyre. Këto trajnime duhet të përfshijnë trajnimet orientuese për të punësuarit e rinj që i bashkohen stafit të Gjykatës Komerciale, për zbatimin e Rregulloreve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës që janë në fushëveprimtari të punës së tyre të përditshme.

Gjithashtu është e nevojshme që edhe për Administratën të zhvillohen programe mentoruese përfshirë edhe takime me ekspertë nga fusha të ndryshme në mënyrë që të rritet efikasiteti dhe cilësia e punës së tyre.

7.3. OBJEKTIVA STRATEGJIKE 3: KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI

Gjykata Komerciale ka prioritet që publiku të jetë i informuar saktë dhe në kohë lidhur me zhvillimet, punën e Gjykatës dhe sistemin e drejtësisë komerciale në përgjithësi. Komunikimi efektiv është një pjesë thelbësore e zhvillimit të mëtejshëm të Gjykatës me qëllim të informimit të publikut për aktivitetet e Gjykatës, proceset dhe procedurat që janë me interes të veçantë, me qëllim të ndërtimit dhe rritjes së besimit të publikut në Gjykatën Komerciale.

Gjykata Komerciale synon të themelojë dhe rris bashkëpunimin edhe me institucionet tjera, odat e profesionistëve ligjorë, shoqatat e bizneseve, autoritetet publike dhe gjykatat komerciale të vendeve të rajonit. Duke punuar së bashku, Gjykata mund të përfitojë nga ndarja e eksperiencave, të forcojë kapacitetet e saj dhe të krijojë një ekosistem për zgjidhjen e kontesteve komerciale.

Qëllimi strategjik 3.1: Rritja e informacionit për publikun për punën e Gjykatës Komerciale

Ndërtimi i besimit të publikut në punën e Gjykatës Komerciale është thelbësor për të siguruar që Gjykata Komerciale është institucion kredibil që kontribuon në rritjen dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë përmes zgjidhjes së kontesteve komerciale në mënyrë të drejtë dhe të rregullt.

Për shkak të ndryshimeve të mëdha dhe të shpejta në sistemin e drejtësisë, shoqëria kosovare dhe publiku i gjerë nuk kanë njohuri të mjaftueshme për sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe në veçanti për Gjykatën Komerciale si gjykatë e re, dhe natyrën e kontesteve të cilat zgjidhen në kuadër të saj. Interesi për të përmirësuar kulturën ligjore dhe njohjen me punën e Gjykatës Komerciale është objektivë thelbësore e kësaj Strategjie. Është përgjegjësi e Gjykatës që të marrë një rol aktiv në edukimin e publikut për drejtësinë komerciale. Kjo është në të mirë të publikut të gjerë, shoqërisë, bizneseve dhe vet sistemit gjyqësor. Si për të gjithë audiencat, kur publiku është i informuar për zhvillimet në një mënyrë gjithëpërfshirëse, mesazhet pozitive rreth ndryshimeve në legjislacionin dhe punën e Gjykatës do të kontribuojnë në imazhin e Gjykatës.

Kjo objektivë përfshin përmirësimin e kanaleve të komunikimit duke ofruar informata për proceset dhe shërbimet e Gjykatës Komerciale.

Qëllimi strategjik 3.2: Vendosja dhe rritja e bashkëpunimit me institucionet vendore

Gjykata Komerciale synon të krijojë dhe mbajë në mënyrë aktive marrëdhëniet me institucionet relevante dhe palët e interesit dhe të krijojë protokollet për shkëmbimin e informacionit. Bashkëpunimi ka për qëllim forcimin e kapaciteteve të Gjykatës, përmirësimin e informimit, rritjen e transparencës, shkëmbimin e informatave, rritjen e cilësisë së punës së Gjykatës Komerciale.

Institucionet e tjera gjithashtu kanë nevojë për informacione në baza të rregullta për të ndihmuar në promovimin dhe zhvillimin e Gjykatës Komerciale. Që reforma në drejtësinë komerciale të ketë sukses, ajo duhet të kuptohet dhe të pranohet nga institucionet dhe akterët kryesorë. Të gjithë duhet të ndajnë entuziazmin dhe të jenë më të përfshirë në procese të caktuara, ku kontributi dhe bashkëpunimi i tyre të njihen në sukseset e Gjykatës Komerciale.

Qëllimi strategjik 3.4: Vendosja dhe rritja e bashkëpunimit me gjykatat komerciale të vendeve të rajonit dhe organizatat ndërkombëtare

Gjykata Komerciale synon të vendos bashkëpunimin me gjykatat komerciale të rajonit. Kjo objektivë është jetike në mbështetjen e Gjykatës në rritjen e profesionalizmit përmes shkëmbimit të informatave lidhur me procedurat dhe praktikave më të mira dhe përmes krijimit të rrjeteve të bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare.

Gjykata Komerciale synon të themelojë dhe të rrisë bashkëpunimin formal me gjykatat homologe në rajon dhe më gjerë si dhe të nënshkruajë memorandume të bashkëpunimit me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira gjyqësore e cila do të ndikojë në rritjen e cilësisë së punës së Gjykatës.

7.4. OBJEKTIVA STRATEGJIKE 4: PROMOVIMI I NJË MJEDISI TË QËNDRUESHËM TË TË BËRIT BIZNES NË KOSOVË

Gjykata Komerciale do të ketë prioritet të kontribuojë në krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm për bizneset në Kosovë, i cili paraqet faktor vendimtar për të tërhequr investimet e huaja, nxitjen e rritjes ekonomike dhe rritjen e sigurisë juridike.

Kjo objektivë do të arrihet përmes rritjes së transparencës, besueshmërisë në zgjidhjen e kontesteve komerciale, përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve gjyqësore dhe zhvillimit të mekanizmave për vet-përmirësim.

Me qëllim të ofrimit të sigurisë juridike dhe unifikimit të vendimeve gjyqësore, kodifikimi i legjislacionit komercial është faktor në promovimin e një mjedisi të qëndrueshëm të të bërit biznes në Kosovë.

Qëllimi strategjik 4.1: Sigurimi i transparencës, qasjes dhe besueshmërisë në zgjidhjen e kontesteve komerciale

Transparenca e proceseve gjyqësore si dhe qasja e publikut janë elemente thelbësore në nxitjen e llogaridhënies dhe rritjen e besimit ndaj Gjykatës. Kjo do të sigurojë që bizneset dhe palët në procedurë të kenë besim në sistemin gjyqësor dhe mund t'i zgjidhin efektivisht kontestet në Gjykatën Komerciale.

Gjyqtarët luajnë rol themelor në ruajtjen e integritetit dhe besueshmërisë së gjyqësorit përmes mbajtjes së standardeve të larta të sjelljes gjyqësore, parimeve etike dhe profesionalizimit.

Qëllimi strategjik 4.2: Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve gjyqësore

Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve dhe punës së Gjykatës Komerciale është thelbësore për të rritur efektivitetin e saj, për të ruajtur besimin e publikut dhe për t'u ofruar bizneseve zgjidhje efikase dhe të drejtë të kontesteve. Ky qëllim përfshin vlerësimin e rregullt dhe përmirësimin e performancës së Gjykatës Komerciale.

Ky proces shërben për të rritur efikasitetin, qasjen dhe cilësinë e shërbimeve që ofrohen nga Gjykata Komerciale. Përmes këtij procesi synohen ndryshime pozitive duke përfshirë digjitalizimin, shkurtimin e kohëzgjatjes së zgjidhjes së lëndëve, trajnimin e personelit dhe promovimin e transparencës me qëllim të ofrimit të një shërbimi më të mirë dhe të qëndrueshëm për të gjithë akterët e përfshirë.

VIII. MONITORIMI DHE RAPORTIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Zbatimi i Strategjisë së Gjykatës Komerciale në masë të konsiderueshme do të varet nga angazhimi i drejtpërdrejtë i menaxhmentit të Gjykatës. Përveç kësaj, zbatimi i suksesshëm i saj, do të varet edhe nga angazhimi gjyqtarëve dhe personelit të Gjykatës për të zbatuar aktivitetet e parapara në Strategji si dhe në aktivitete të caktuara edhe nga mbështetja e KGJK-së, Akademisë së Drejtësisë dhe institucioneve tjera. Gjithsesi, monitorimi i vazhdueshëm, raportimi dhe vlerësimi i zbatimit të Strategjisë si dhe identifikimi me kohë i problemeve dhe sfidave janë kyçe në zbatimin e suksesshëm.

Ekzistojnë dy faza gjatë të cilave suksesi i Strategjisë monitorohet, raportohet dhe vlerësohet:

- **Faza e parë** - Monitorimi dhe raportimi i Strategjisë dhe
- **Faza e dytë** – Vlerësimi i Strategjisë

Përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë së Gjykatës Komerciale është Komisioni për Administrimin e Gjykatave (KAGJ). Kryetari, Nënkyetarja dhe Administratori i Gjykatës janë të obliguar që të raportojnë çdo 6 muaj pranë Komisionit për Administrimin e Gjykatave (KAGJ) lidhur me zbatimin e objektivave të planit, gjegjësisht lidhur me përgjegjësitë të cilat i kanë në bazë të Strategjisë, ndërsa udhëheqësit e njësive/zyreve janë përgjegjës për zbatimin e veprimeve të planit që korrespondojnë me përgjegjësitë dhe autorizimet e njësive/zyreve që i udhëheqin. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të Planit të Veprimit do të bëhet në baza periodike përmes raportimeve të përgatitura nga njësitë dhe personat përgjegjës të përcaktuar në Planin e Veprimit të cilat do të dorëzohen te Kryetari, Nënkyetarja dhe Administratori i Gjykatës.

Vlerësimi i vëllimit/nivelit të realizimit të objektivave të planifikuara do të bëhet në fund të vitit 2024, ndërsa vlerësimi final në fund të vitit 2025, duke vlerësuar:

- **Aspektet sasore** – në kuptim të vëllimit të punëve të kryera në raport me objektivat strategjike.
- **Aspektet cilësore** – në kuptim të kualitetit të punës të çdo njësie ose personi përgjegjës në raport me objektivat strategjike.
- **Aspekti kohor** – në kuptim të realizimit të objektivave të parapara brenda afateve të përcaktuara.

IV. NDIKIMI FINANCIAR I STRATEGJISË

Realizimi i Strategjisë financohet nga buxheti i Gjykatës për vitet 2024 dhe 2025, ndërsa për disa nga aktivitetet e caktuara të kësaj Strategjie do të kërkohet mundësia e financimit shtesë nga KGJK.

Në mungesë të mjeteve, aktivitete të caktuara do të mund të mbështetën nga organizatat ndërkombëtare në Kosovë, të cilat operojnë në fushën e drejtësisë në pajtim me objektivat dhe planifikimet e tyre.

NDIKIMI FINANCIAR				
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE:	Viti 2024:	Viti 2025:	Shuma e përgjithshme për vitet 2024 dhe 2025:	Shuma për financim nga KGJK:
Objektiva strategjike 1:	321,662 EUR	197,852 EUR	519,514 EUR	253,424 EUR
Objektiva strategjike 2:	29,225 EUR	11,800 EUR	41,025 EUR	0 EUR
Objektiva strategjike 3:	28,460 EUR	18,910 EUR	47,370 EUR	27,450 EUR
Objektiva strategjike 4:	700 EUR	4,550 EUR	5,250 EUR	0 EUR
SHUMA E PËRGJITHSHME:	380,047 EUR	233,112 EUR	<u>613,159 EUR</u>	280,874 EUR

X. MENAXHIMI I RISKUT

Duke u bazuar në vëllimin e aktiviteteve, kapaciteteve njerëzore, kapaciteteve profesionale dhe materiale, është paraparë lista dhe menaxhimi i riskut si në vijim:

- Mungesa e objektit dhe hapësirave adekuate për punë;
- Ngarkesa e gjyqtarëve me lëndët e vjetra të transferuara nga gjykatat tjera;
- Ngarkesa shtesë e personelit të Gjykatës në punë dytësore administrative;
- Mosplotësimi i pozitave të lira për gjyqtarë dhe staf tjetër;
- Mospërputhje kohore e raportimeve nga njësitë përkatëse;
- Dështimi në miratimin e buxhetit sipas kërkesave të Gjykatës, do ta zvogëlonin efikasitetin e pritur nga veprimet e propozuara.

Menaxhimi i riskut do të bëhet duke ndërmarrë veprimet si në vijim:

- Do të bëhet mobilizimi i të gjithë personelit të Gjykatës për të plotësuar vakumet e personelit, në mënyrë që të gjitha objektivat strategjike të realizohen me kohë;
- Do të analizohet mundësia e mbështetjes së aktiviteteve të caktuara nga organizatat ndërkombëtare që operojnë në Kosovë;
- Do të analizohet mundësia e angazhimit të ekspertëve nga fushat përkatëse dhe sipas kontratave për punë specifike, për të realizuar vëllimin e punëve të planifikuara.

XI. INDIKATORËT

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 1:

DREJTËSI E PARASHIKUESHME DHE BRENDA KOHËS SË ARSYESHME

Qëllimi strategjik 1.1: Ngritja e cilësisë së vendimeve

Nr.	Indikatorët:	Vlera bazë: ⁷	Caku për vitin 2024: ⁸	Caku për vitin 2025: ⁹
1.	Numri i vendimeve kundër të cilave paraqitet ankesë ¹⁰		/	/
2.	Numri i lëndëve që kthehen nga shkalla e dytë		/	/
3.	Numri i vendimeve të shkallës së dytë kundër të cilave paraqitet mjet juridik		/	/
4.	Numri i trajnimeve/aktiviteteve të organizuara për hulumtime dhe kërkime ligjore	0	2	4

Qëllimi strategjik 1.2: Përmirësimi i infrastrukturës dhe burimeve të Gjykatës

Nr.	Indikatorët:	Vlera bazë:	Caku për vitin 2024:	Caku për vitin 2025:
1.	Objekti i ri i Gjykatës i siguruar	Jo	Po	Po
2.	Plotësimi i të gjitha pozitave të parapara për gjyqtarë	18	20	20
3.	Plotësimi i pozitave për bashkëpunëtorë	17	20	20
4.	Plotësimi i pozitave të stafit administrativ	25	53	53

Qëllimi strategjik 1.3: Unifikimi i praktikës gjyqësore

Nr.	Indikatorët:	Vlera bazë:	Caku për vitin 2024:	Caku për vitin 2025:
1.	Buletini i krijuar	0	1	1
2.	Përmbledhje e praktikës së huaj gjyqësore	0	0	1

⁷ Vlera bazë paraqet vlerën gjatë vitit 2023

⁸ Caku për vitin 2024 përfshin cakun vetëm për këtë vit

⁹ Caku për vitin 2025 përfshin cakun vetëm për këtë vit

¹⁰ Caqet për vitet 2024 dhe 2025 për indikatorët 1, 2 dhe 3 varen nga numri i lëndëve dhe mjeteve juridike që paraqiten ndaj tyre

3.	Takimet periodike të gjyqtarëve të mbajtura	20	25	30
Qëllimi strategjik 1.4: Zvogëlimi i stoqeve të lëndëve të vjetra				
Nr.	Indikatorët:	Vlera bazë:	Caku për vitin 2024:	Caku për vitin 2025:
1.	Numri i lëndëve të vjetra të pranuar nga gjykatat tjera ¹¹	10,000	/	/
2.	Numri i lëndëve të vjetra të zgjidhura		/	/
Qëllimi strategjik 1.5: Avancimi i sistemit digjital për menaxhimin e lëndëve				
Nr.	Indikatorët:	Vlera bazë:	Caku për vitin 2024:	Caku për vitin 2025:
1.	Përqindja e lëndëve që trajtohen plotësisht përmes SMIL	1%	100%	100%
2.	Manuali për menaxhimin e lëndëve i hartuar	0	1	1
Qëllimi strategjik 1.6: Përdorimi i ndërmjetësimit si mekanizëm për zgjidhjen alternative të kontesteve				
Nr.	Indikatorët:	Vlera bazë:	Caku për vitin 2024:	Caku për vitin 2025:
1.	Numri i lëndëve komerciale të referuara në ndërmjetësim	30	150	240
OBJEKTIVA STRATEGJIKE 2:				
RRITJA E EKSPERTIZËS NË FUSHËN KOMERCIALE				
Qëllimi strategjik 2.1: Trajnimet për gjyqtarë				
Nr.	Indikatorët:	Vlera bazë:	Caku për vitin 2024:	Caku për vitin 2025:
1.	Numri i trajnimeve nga fusha komerciale të përfshira në Programin e Trajnimeve të Vazhduara	12	11	11
2.	Numri i mentorimeve	2	2	0
3.	Numri i platformave online që iu është ofruar qasja gjyqtarëve	2	3	1
4.	Numri i gjyqtarëve të trajnuar	17	20	20
Qëllimi strategjik 2.2: Trajnimet për Njësinë Ligjore				

¹¹ Ky indikator vlen për periudhën sa janë pranuar lëndët e transferuara. I njëjti nuk është relevant për vitet e ardhshme.

Nr.	Indikatorët:	Vlera bazë:	Caku për vitin 2024:	Caku për vitin 2025:
1.	Numri i trajnimeve nga fusha komerciale të përfshira në Programin e Trajnimeve të Vazhduara	12	11	11
2.	Numri i mentorimeve	0	4	2
3.	Numri i platformave online që iu është ofruar qasja Njesisë Ligjore	2	3	1
4.	Numri i të trajnuarve	13	33	35
Qëllimi strategjik 2.3: Trajnimet për Administratën				
Nr.	Indikatorët:	Vlera bazë:	Caku për vitin 2024:	Caku për vitin 2025:
1.	Numri i trajnimeve	0	10	10
2.	Numri i mentorimeve	0	0	0
3.	Numri i të trajnuarve	0	20	30
OBJEKTIVA STRATEGJIKE 3: KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI				
Qëllimi strategjik 3.1: Rritja e informacionit për publikun për punën e Gjykatës Komerciale				
Nr.	Indikatorët:	Vlera bazë:	Caku për vitin 2024:	Caku për vitin 2025:
1.	Numri i vendimeve të publikuara në Ëebfaqe	4451 ¹²	3000	3000
2.	Numri i njoftimeve të publikuara për seanca gjyqësore	1557	2000	2000
3.	Numri i njoftimeve të publikuara në rrjetet sociale dhe ëebfaqe për aktivitetet e Gjykatës Komerciale	50	75	100
Qëllimi strategjik 3.2: Vendosja dhe rritja e bashkëpunimit me institucionet vendore				
Nr.	Indikatorët:	Vlera bazë:	Caku për vitin 2024:	Caku për vitin 2025:
1.	Numri i institucioneve, odave të profesionistëve ligjorë, shoqatat e biznesit, universitetet me të cilat është vendosur bashkëpunimi	6	7	8

¹² Për këtë indikator nuk mund të vendosen caqet për vitet e ardhshme, pasi që varet nga trendi i pranimit/zgjidhjes së lëndëve

2.	Numri i takimeve të mbajtura me institucionet, odat, shoqatat e bizneseve me të cilat është vendosur bashkëpunimi	12	14	16
3.	Numri i formalizimeve të bashkëpunimit	1	1	2

Qëllimi strategjik 3.3: Themelimi dhe rritja e bashkëpunimit me gjykatat komerciale të vendeve të rajonit dhe organizatat ndërkombëtare

Nr.	Indikatorët:	Vlera bazë:	Caku për vitin 2024:	Caku për vitin 2025:
1.	Numri i iniciativave të marra për vendosjen e bashkëpunimit me gjykatat e vendeve tjera dhe organizatave ndërkombëtare	0	1	2
2.	Numri i formalizimeve të bashkëpunimit me organizatave ndërkombëtare dhe gjykata të vendeve tjera	0	0	1
3.	Numri i pjesëmarrjes në aktivitetet regionale/ndërkombëtare	0	1	2

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 4:

PROMOVIMI I NJË MJEDISI TË QËNDRUESHËM TË TË BËRIT BIZNES NË KOSOVË

Qëllimi strategjik 4.1: Sigurimi i transparencës, qasjes dhe besueshmërisë në zgjidhjen e kontesteve komerciale¹³

Nr.	Indikatorët:	Vlera bazë:	Caku për vitin 2024:	Caku për vitin 2025:
1.	Koha mesatare për zgjidhjen e kontesteve komerciale për lëndët e transferuara nga gjykatat tjera			
2.	Koha mesatare për zgjidhjen e kontesteve komerciale për lëndët e pranuar për herë të parë nga 1 gusht 2022 e tutje			
3.	Koha e përgjithshme mesatare për zgjidhjen e lëndëve të transferuara dhe atyre të pranuar për herë të parë			
4.	Numri i kërkesave për qasje në dokumente zyrtare			

¹³ Indikatorët e "Qëllimit strategjik 4.1", në pamundësi teknike të gjenerimit të tyre përmes regjistrave manual, do të vendosen pas Vlerësimit të Strategjisë, në rishikimin e saj afatmesëm, pas një viti.

5.	Përqindja e kërkesave për qasje në dokumente zyrtare që kanë marrë përgjigje nga Gjykata Komerciale			
Qëllimi strategjik 4.2: Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve gjyqësore				
Nr.	Indikatorët:	Vlera bazë:	Caku për vitin 2024:	Caku për vitin 2025:
1.	Zhvillimi i standardeve për monitorim dhe vlerësim	0	1	1
2.	Zhvillimi i pyetësorëve me palët për vlerësimin e punës së Gjykatës	0	1	1
3.	Numri i pyetësorëve të zhvilluar	0	1	1
4.	Numri i pyetësorëve të plotësuar	0	50	70

XII. PLANI I VEPRIMIT

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 1: DREJTËSI E PARASHIKUESHME DHE BRENDA KOHËS SË ARSYESHME							
Qëllimi strategjik 1.1: Ngritja e cilësisë së vendimeve							
Nr.	Aktivitetet:	Institucioni/Njësia/Personi përgjegjës:	Periudha kohore e zbatimit:	Buxheti:		Burimi i financimit:	Produkti (Output):
				2024	2025		
1.	Qasja në platformat online për hulumtime	Gjykata Komerciale Akademia e Drejtësisë Donatorët	2024 - 2025	2,400 EUR	2,400 EUR	KGJK Donatorët	Qasja në platforma online për hulumtime
2.	Krijimi i bibliotekës	Gjykata Komerciale Donatorët	2024-2025	1,000 EUR	1,000 EUR	Gjykata Komerciale Donatorët	Biblioteka
3.	Organizimi i trajnimeve për hulumtime ligjore	Gjykata Komerciale Akademia e Drejtësisë Donatorët	2024-2025	2,000 EUR	1,040 EUR	Akademia e Drejtësisë Gjykata Komerciale	Trajnimet e mbajtura
4.	Hartimi i formave standarde të vendimeve	Gjykata Komerciale Donatorët	2024-2025	650 EUR	650 EUR	Gjykata Komerciale Donatorët	Format standarde të vendimeve të hartuara
TOTALI: 11,140 EUR				6,050 EUR	5,090 EUR		
Qëllimi strategjik 1.2: Përmirësimi i infrastrukturës dhe burimeve të Gjykatës							
Nr.	Aktivitetet:	Institucioni/Njësia/Personi përgjegjës:	Periudha kohore e zbatimit:	Buxheti:		Burimi i financimit:	Produkti (Output):
				2024	2025		
1.	Sigurimi i objektit të ri të Gjykatës	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	2024	/	/	KGJK	Objekti i ri i Gjykatës Komerciale

2.	Sigurimi i inventarit adekuat	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	2024	8,000 EUR	6,000 EUR	KGJK	Inventari i siguruar
3.	Sigurimi i pajisjeve kompjuterike	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	2024	21,000 EUR	7,000 EUR	KGJK Programi i USAID për Drejtësi Komerciale	Pajisjet kompjuterike të siguruara
4.	Sigurimi i kushteve të punës dhe mallrave tjera	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	2024	/	/	KGJK	Furnizimi me mallra në kohë dhe kushtet e punës të siguruara
5.	Plotësimi i pozitave të lira për gjyqtarë	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	2024	51,606 EUR	51,606 EUR	KGJK	Pozitat e parapara për gjyqtarë të plotësuar
6.	Plotësimi i të gjitha pozitave të lira për bashkëpunëtorë	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	2024	19,536 EUR	19,536 EUR	KGJK	Pozitat e parapara për bashkëpunëtorë të plotësuar
7.	Plotësimi i pozitave të lira të stafit administrativ	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	2024	35,100 EUR	35,100 EUR	KGJK	Pozitat administrative vakante të plotësuar
TOTALI: 254,484 EUR				135,242 EUR	119,242 EUR		

Qëllimi strategjik 1.3: Unifikimi i praktikës gjyqësore

Nr.	Aktivitetet:	Institucioni/Njësia/Personi përgjegjës:	Periudha kohore e zbatimit:	Buxheti:		Burimi i financimit:	Produkti (Output):
				2024	2025		
1.	Zhvillimi i Buletinit të praktikës gjyqësore	Gjykata Komerciale	Dhjetor 2024 Dhjetor 2025	/	/	Gjykata Komerciale Donatorët	Buletini i praktikës gjyqësore për çështjet komerciale i vitit 2024
		Donatorët				Gjykata Komerciale Donatorët	Buletini i praktikës gjyqësore për çështjet komerciale i vitit 2025
2.	Përmbledhje e praktikës së huaj gjyqësore	Gjyqtarët e Shkallës së Dytë	Dhjetor 2025	/	/	Gjykata Komerciale Donatorët	Përmbledhja e praktikës së huaj
3.		Unifikuesi i praktikës gjyqësore	Çdo muaj	/	/	/	Kolegjiumet e mbajtura

	Mbajtja e kolegjiemeve lidhur me unifikimin e praktikës gjyqësore	Gjyqtarët e Shkallës së Dytë					
4.	Mbajtja e takimeve të gjyqtarëve të Shkallës së Parë me Unifikuesin e praktikës gjyqësore	Gjyqtarët e Shkallës së Parë Unifikuesi i Praktikës gjyqësore	Çdo muaj	/	/	/	Takimet e mbajtura
5.	Komunikimi i vendimeve të Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese në kohë	Zyra për Komunikim	Në vazhdimësi	/	/	/	Vendimet e komunikuara në kohë
6.	Adresimi i çështjeve në praktikën gjyqësore nga Kolegjiumi i Shkallës së Dytë sipas të gjeturave nga gjyqtarët e Shkallës së Parë	Kolegjiumi i Shkallës së Dytë	Në vazhdimësi	/	/	/	Raporti mbi çështjet e adresuara
TOTALI				/	/	/	
Qëllimi strategjik 1.4: Zvogëlimi i stokeve të lëndëve të vjetra							
Nr.	Aktivitetet:	Institucioni/Njësia/Personi përgjegjës:	Periudha kohore e zbatimit:	Buxheti:		Burimi i financimit:	Produkti (Output):
				2024	2025		
1.	Identifikimi i lëndëve të trashëguara/transferuara	Zyra për Menaxhimin e Lëndëve	Në vazhdimësi	/	/	Gjykata Komerciale	Lëndët e trashëguara të identifikuar
2.	Identifikimi i lëndëve të paraqitura për herë të parë në Gjykatën Komerciale	Zyra për Menaxhimin e Lëndëve	Në vazhdimësi	/	/	Gjykata Komerciale	Lëndët e paraqitura për herë të parë të identifikuar
3.	Inventarizimi i lëndëve <i>'backlog'</i> sipas natyrës	Zyra për Menaxhimin e lëndëve		/	/	Gjykata Komerciale	Lëndët e backlog-ut të inventarizuara
4.	Hartimi i Planit Vjetor për prioritetimin e lëndëve të <i>backlogut</i>	Kryetari Nënkryetarja Administratori Udhëheqësit e Departamenteve	Dhjetor 2023 Dhjetor 2024	/	/	Gjykata Komerciale	Plani Vjetor për prioritetimin e lëndëve të backlogut

			Dhjetor 2025				
5.	Themelimi i zyrës për shqyrtim paraprak të padive	Gjykata Komerciale		8,120 EUR	7,020 EUR	Gjykata Komerciale KGJK	Zyra për shqyrtimin paraprak të padive e themeluar
6.	Ndryshimi i Planit Strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi, efikasiteti, prioritizimi i lëndëve brenda sistemit gjyqësor 2022-2025 me qëllim të adresimit të nevojave specifike të Gjykatës Komerciale për reduktimin e lëndëve	Këshilli Gjyqësor i Kosovës Gjykata Komerciale	Dhjetor 2023 Dhjetor 2024 Dhjetor 2025	/	/	Gjykata Komerciale KGJK	Planit Strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi, efikasiteti, prioritizimi i lëndëve brenda sistemit gjyqësor 2022-2025 i ndryshuar
TOTALI: 15,140 EUR				8,120 EUR	7,020 EUR		
Qëllimi strategjik 1.5: Funkcionalizimi i sistemit digjital për menaxhimin e lëndëve							
Nr.	Aktivitetet:	Institucioni/Njësia/Personi përgjegjës:	Periudha kohore e zbatimit:	Buxheti:		Burimi i financimit:	Produkti (Output):
				2024	2025		
1.	Optimizimi i SMIL për menaxhimin e rasteve	Këshilli Gjyqësor i Kosovës Gjykata Komerciale Donatorët	2024/2025	168,000 EUR	65,000 EUR	Programi USAID për Drejtësi Komerciale	Përditësimi i SMIL-it Zhvillim i sistemit të ri Gjyqtarët dhe stafi i trajnuar Sistemi i zhvilluar Manuali për menaxhimin e lëndëve
3.	Zgjerimi në gamën e pranimit të shënimeve nga ndërlihdjet ekzistuese të SMIL (ARBK)	Këshilli Gjyqësor i Kosovës Donatorët	2024				
4.	Zhvillimi i veglave për lehtësim dhe monitorim të Gjykatës Komerciale (dataëarehouse)	Këshilli Gjyqësor i Kosovës Donatorët	2024 2025				
5.	Integrimi i Sistemit për mbështetje në klasifikimin e shënimeve/dokumenteve	Këshilli Gjyqësor i Kosovës Donatorët	2024 2025				

6.	Trajnimi i gjyqtareve dhe stafit për SMIL	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	2023 2024				
7.	Zhvillimi i sistemit për lëshimin e çertifikatës digjitale për biznese që nuk është në procedurë të falimentimit	Këshilli Gjyqësor i Kosovës Donatorët	2024				
8.	Zhvillimi i sistemit për lëshimin e çertifikatës digjitale për verifikimin nëse biznesi është në procedurë të falimentimit	Këshilli Gjyqësor i Kosovës Donatorët	2024				
9.	Hartimi i Manualit për menaxhimin e lëndëve	Gjykata Komerciale Donatorët	2024				
TOTALI: 233,000 EUR				168,000 EUR	65,000 EUR		
Qëllimi strategjik 1.6: Rritja e përdorimit të mekanizmave për zgjidhjen alternative të kontesteve							
Nr.	Aktivitetet:	Institucioni/Njësia/Personi përgjegjës:	Periudha kohore e zbatimit:	Buxheti:		Burimi i financimit:	Produkti (Output):
				2024	2025		
1.	Hartimi i planit për referim të rasteve në ndërmjetësim	Këshilli Gjyqësor i Kosovës Gjykata Komerciale	2025	/	/	Gjykata Komerciale KGJK	Plani për referim të rasteve në ndërmjetësim
2.	Referimi i rasteve të përshtatshme në ndërmjetësim	Gjykata Komerciale	Në vazhdimësi	/	/	Gjykata Komerciale	Rastet e referuara
3.	Trajtimi me prioritet i kërkesave për njohjen e vendimeve të arbitrazhit në pajtim me Ligjin	Gjykata Komerciale	Në vazhdimësi	/	/	Gjykata Komerciale	Njohja e vendimeve të arbitrazhit
4.	Trajnimi i gjyqtarëve për përdorimin e mekanizmave për zgjidhjen alternative të kontesteve	Akademia e Drejtësisë	2024	4,250 EUR	1,500 EUR	Programi i USAID për Drejtësi Komerciale	Gjyqtarët e trajnuar Stafi i Njesisë Ligjore i trajnuar
TOTALI: 5,750 EUR				4,250 EUR	1,500 EUR		

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 2: RRITJA E EKSPERTIZËS NË FUSHËN KOMERCIALE							
Qëllimi strategjik 2.1: Trajnimet për gjyqtarë							
Nr.	Aktivitetet:	Institucioni/Njësia/Personi përgjegjës:	Periudha kohore e zbatimit:	Buxheti:		Burimi i financimit:	Produkti (Output):
				2024	2025		
1.	Zgjerimi i kurrikulës së trajnime për të drejtën komerciale në Programin e Vazhdueshëm të trajnimeve të Akademisë së Drejtësisë	Gjykata Komerciale Akademia e Drejtësisë Donatorët	2024	10,400 EUR	5,200 EUR	Akademia e Drejtësisë Donator	Kurrikula e Programit të Vazhdueshëm të Trajnimeve e zgjeruar edhe me trajnime për të drejtën komerciale
2.	Integrimi i perspektivës gjinore në kurrikulën e trajnimeve për të drejtën komerciale	Akademia e Drejtësisë Donatorët	2024 2025	5,225 EUR	1,150 EUR	Akademia e Drejtësisë Donator	Perspektiva gjinore në Kurrikulën e Programit të Trajnimeve për të drejtën komerciale e integruar
3.	Zhvillimi i programit mentorues për gjyqtarë	Gjykata Komerciale Donatorët	2025	10,000 EUR	3,500 EUR	Akademia e Drejtësisë Donator	Programet mentoruese të zhvilluara
4.	Analizimi dhe vlerësimi i nevojave për trajnime të gjyqtarëve dhe Njesisë Ligjore nga vet gjyqtarët e Gjykatës Komerciale	Gjykata Komerciale	TM1 2024	/	/	/	Raporti i brendshëm i vlerësimit të nevojave të trajnimeve
5.	Zhvillimi i Planit të Trajnimeve të mbajtura nga gjyqtarët e Gjykatës Komerciale për gjyqtarë dhe Njësinë Ligjore	Gjykata Komerciale	TM1 2024	/	/	Gjykata Komerciale	Plani i trajnimeve i zhvilluar
TOTALI: 35,475 EUR				25,625 EUR	9,850 EUR		
Qëllimi strategjik 2.2: Trajnimet për Njësinë Ligjore							
Nr.	Aktivitetet:			Buxheti:			Produkti (Output):

		Institucioni/Njësia/Personi përgjegjës:	Periudha kohore e zbatimit:	2024	2025	Burimi i financimit:	
1.	Zgjerimi i kurrikulës së trajnimeve për të drejtën komerciale në Programin e Vazhdueshëm të trajnimeve të Akademisë së Drejtësisë	Gjykata Komerciale Akademia e Drejtësisë Donatorët	2024	0 EUR	0 EUR	Akademia e Drejtësisë	Kurrikula e Programit të Vazhdueshëm të Trajnimeve e zgjeruar edhe me trajnime për të drejtën komerciale
2.	Zhvillimi i programit mentorues për Njësinë Ligjore	Akademia e Drejtësisë Gjykata Komerciale Donatorët	2025	2,000 EUR	1,000 EUR	Akademia e Drejtësisë Donator	Programet mentoruese të zhvilluara
TOTALI: 3,000 EUR				2,000 EUR	1,000 EUR		
Qëllimi strategjik 2.3: Trajnimet për Administratën							
Nr.	Aktivitetet:	Institucioni/Njësia/Personi përgjegjës:	Periudha kohore e zbatimit:	Buxheti:		Burimi i financimit:	Produkti (Output):
				2024	2025		
1.	Zhvillimi i Programit Orientues për Administratën	Administratori Donatorët	2024	1,100 EUR	950 EUR	Donator	Programi Orientues për Administratën i zhvilluar
2.	Zhvillimi i programit mentorues për Administratën	Akademia e Drejtësisë Donatorët	2025	500 EUR	/	Akademia e Drejtësisë	Programi Mentorues për Administratën i zhvilluar
TOTALI 2,550 EUR				1,600 EUR	950 EUR		
OBJEKTIVA STRATEGJIKE 3: KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI							
Qëllimi strategjik 3.1: Rritja e informacionit për publikun për punën e Gjykatës Komerciale							
Nr.	Aktivitetet:	Institucioni/Njësia/Personi përgjegjës:	Periudha kohore e zbatimit:	Buxheti:		Burimi i financimit:	Produkti (Output):
				2024	2025		

1.	Publikimi i vendimeve në Ëebfaqe	Zyra për Informim dhe Komunikim me Media	Në vazhdimësi	/	/	Gjykata Komerciale	Vendimet gjyqësore të publikuara
2.	Publikimi i tabelës së seancave	Zyra për Informim dhe Komunikim me Media	Në vazhdimësi	/	/	Gjykata Komerciale	Tabela e seancave e përditësuar
3.	Përgatitja dhe publikimi i njoftimeve në ëebfaqe i të dhënave statistikore për punën e Gjykatës	Zyra për Informim dhe Komunikim me Media	Në vazhdimësi	/	/	Gjykata Komerciale	Të dhënat statistikore të publikuara
4.	Publikimi i njoftimeve/materialeve me ndjeshmëri gjinore për informim të publikut në ëebfaqe dhe rrjetet sociale	Zyra për Informim dhe Komunikim me Media	Në vazhdimësi	/	/	Gjykata Komerciale	Njoftimet/materialet e publikuara në ëebfaqe dhe në rrjetet sociale
5.	Vendosja e këndit për ankesa të palëve për punën e Gjykatës	Kryetari i Gjykatës Nënkryetarja Administratori Zyra për Informim dhe Komunikim me Media	2024	400 EUR	/	Gjykata Komerciale Donator	Këndi për ankesa të palëve i vendosur
6.	Hartimi i Planit Vjetor të Punës	Kryetari Nënkryetarja	Nëntor 2024 Nëntor 2025	760 EUR	760 EUR	Gjykata Komerciale Donator	Plani i Punës për vitin 2024 Plani i Punës për vitin 2025
7.	Hartimi i Raportit Vjetor të Punës	Kryetari Nënkryetarja	Dhjetor 2024 Dhjetor 2025	1,000 EUR	1,000 EUR	Gjykata Komerciale Donator	Raporti i Punës për vitin 2024 Raporti i Punës për vitin 2025
8.	Publikimi i Planit Vjetor të Punës	Zyra për Informim dhe Komunikim me Media	Dhjetor 2024 Dhjetor 2025	/	/	Gjykata Komerciale	Plani Vjetor i publikuar
9.	Publikimi i Raportit Vjetor	Zyra për Informim dhe Komunikim me Media	Janar 2025 Janar 2026	/	/	Gjykata Komerciale	Raporti Vjetor i publikuar
TOTALI: 3,920 EUR				2,160 EUR	1,760 EUR		

Qëllimi strategjik 3.2: Vendosja dhe rritja e bashkëpunimit me institucionet vendore							
Nr.	Aktivitetet:	Institucioni/Njësia/Personi përgjegjës:	Periudha kohore e zbatimit:	Buxheti:		Burimi i financimit:	Produkti (Output):
				2024	2025		
1.	Vendosja e bashkëpunimit me institucionet akademike, organizata profesionale	Kryetari i Gjykatës Nënkryetarja	2024	/	/	Gjykata Komerciale	Bashkëpunimi me institucionet akademike dhe organizatat profesionale i vendosur
2.	Mbajtja e takimeve të rregullta me institucionet, odat, shoqatat e bizneseve	Kryetari i Gjykatës Nënkryetarja	2024	2,300 EUR	1,150 EUR	Gjykata Komerciale	Takimet e rregullta me institucionet, odat, shoqatat e bizneseve
3.	Formalizimi i bashkëpunimit me institucionet vendore	Zyra për Informim dhe Komunikim me Media	2024	/	/	Gjykata Komerciale	Bashkëpunimi me institucionet vendore i formalizuar
TOTALI: 3,450 EUR				2,300 EUR	1,150 EUR		
Qëllimi strategjik 3.3: Themelimi dhe rritja e bashkëpunimit me gjykatat komerciale të vendeve të rajonit dhe organizatat ndërkombëtare							
Nr.	Aktivitetet:	Institucioni/Njësia/Personi përgjegjës:	Periudha kohore e zbatimit:	Buxheti:		Burimi i financimit:	Produkti (Output):
				2024	2025		
1.	Ndërmarrja e iniciativave për vendosjen e bashkëpunimit me gjykatat komerciale të vendeve tjera dhe organizata ndërkombëtare	Kryetari i Gjykatës Nënkryetarja	2024 2025	/	/	Gjykata Komerciale	Iniciativat për vendosjen e bashkëpunimit me gjykatat komerciale të vendeve tjera dhe organizatat ndërkombëtare
2.	Formalizimi i bashkëpunimit me gjykatat komerciale të vendeve të rajonit	Kryetari i Gjykatës	2024 2025	8,000 EUR	4,000 EUR	Gjykata Komerciale (buxhet shtesë)	Bashkëpunimi me gjykatat e rajonit i formalizuar
3.	Pjesëmarrja në aktivitetet regjionale dhe ndërkombëtare	Kryetari i Gjykatës Nënkryetarja	2024 2025	8,000 EUR	4,000 EUR	Gjykata Komerciale	Pjesëmarrja në aktivitete regjionale dhe ndërkombëtare

		Gjyqtarë dhe staf i Gjykatës Komerciale				(buxhet shtesë)	Pjesëmarrja në ëëbinare dhe aktivitete online
TOTALI: 24,000 EUR				16,000 EUR	8,000 EUR		
OBJEKTIVA STRATEGJIKE 4: PROMOVIMI I NJË MJEDISI TË QËNDRUESHËM TË TË BËRIT BIZNES NË KOSOVË							
Qëllimi strategjik 4.1: Sigurimi i transparencës, qasjes dhe besueshmërisë në zgjidhjen e kontesteve komerciale							
Nr.	Aktivitetet:	Institucioni/Njësia/Personi përgjegjës:	Periudha kohore e zbatimit:	Buxheti:		Burimi i financimit:	Produkti (Output):
				2024	2025		
1.	Zvogëlimi i kohës mesatare për zgjidhjen e kontesteve komerciale	Gjykata Komerciale	Në vazhdimësi	/	/	Gjykata Komerciale	Koha e zgjidhjes së kontesteve komerciale e zvogëluar
2.	Informimi i palëve lidhur me ecurinë e lëndës	Zyra për Informim dhe Komunikim me Media	Në vazhdimësi	/	/	Gjykata Komerciale	Palët e informuara
3.	Publikimi i raporteve statistikore	Zyra për Informim dhe Komunikim me Media	Periodikisht	/	/	Gjykata Komerciale	Raportet statistikore të publikuara
TOTALI: 0 EUR				/	/		
Qëllimi strategjik 4.2: Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve gjyqësore							
Nr.	Aktivitetet:	Institucioni/Njësia/Personi përgjegjës:	Periudha kohore e zbatimit:	Buxheti:		Burimi i financimit:	Produkti (Output):
				2024	2025		
1.	Zhvillimi i standardeve për monitorim dhe vlerësim	Gjykata Komerciale	Dhjetor 2024	/	/	Programi i USAID për Drejtësi Komerciale	Standardet për monitorim dhe vlerësim të zhvilluara
2.	Zhvillimi i pyetësorëve me palët për vlerësimin e punës së Gjykatës	Gjykata Komerciale	2024	700 EUR	1,050 EUR	Gjykata Komerciale Programi i USAID për	Pyetësori për vlerësimin e punës së Gjykatës

						Drejtësi Komerçiale	
3.	Adresim i të gjeturave të pyetësorëve	Gjykata Komerçiale	2024	/	3,500 EUR	Programi i USAID për Drejtësi Komerçiale	Përmbledhje e të gjeturave të pyetësorit
TOTALI: 5,250 EUR				700 EUR	4,550 EUR		



Republika e Kosovës
Republika Kosova | Republic of Kosovo



Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Sudski Savet Kosova | Kosovo Judicial Council